

VENDIM
Nr. 140, datë 22.2.2017

PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË
Z. ALBERT DAMJANECI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr.18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të z. Albert Damjaneci, në masën 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë.
 2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama